



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI QARKUT
TIRANË

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Specialist i protokollit, arkivës dhe shërbimit ndaj qytetarëve në Këshillin e Qarkut Tiranë

Lloji i diplomës "Shkenca inxhinierike: inxhinieri ndërtimi/arkitekt/urbanist". Niveli diplomës "Master Shkencor"

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit nr.243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Qarkut Tiranë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive për pozicionin:

- **1 (një) Specialist i protokollit, arkivës dhe shërbimit ndaj qytetarëve, në Drejtorinë Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore kategoria IV-a**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

Afati për dorëzimin edokumentave për:

LËVIZJE PARALELE:

16 dhjetor 2019

Afati për dorëzimin edokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIM CIVIL:

21 dhjetor 2019

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Specialisti i protokollit arkivës dhe shërbimit ndaj qytetarëve ka për mision që në mbështetje të legjislacionit në fuqi për arkivat, normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, rregullave për punën me arkivat teknike (arkiva urbanistike), të garantojë administrimin e dokumentacionit arkivor dhe dokumentacionit arkivor teknik urbanistik. Në mbështetje të legjislacionit për të drejtën e informimit akteve ligjore në të cilën mbështetet veprimtaria dhe funksionimi i administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë të ofrojë informacion dhe shërbim sa më cilësor ndaj qytetarëve për çdo kërkesë, ankesë. Kryen veprimet për pranimin, evidencimin, shpërndarjen dhe nisjen e korrespondencës, hap dosjet sipas pasqyrës emërtuese të çeljes së tyre dhe vendos e sistemon në to, në mënyrë të vazhdueshme, dokumentet që krijohen e vijnë gjatë vitit, mirëmban e ruan vulat dhe dokumentet e krijuara apo të hyra ne institucion si dhe dokumentet arkivore teknike urbanistike; dokumentacion tekniko ligjor për lejet e ndërtimit të miratuara dokumentacionin e kadastrës urbane, planet rregulluese, vijat kufizuese të ndërtimit (vijat e verdha), plan vendosjet e objekteve të miratuara. Trajton çdo kërkesë nga subjektet juridike fizike private dhe publike si dhe institucioneve shtetërore qendrore e lokale për paisje me dokumentacion arkivor teknik urbanistik.

1 LËVIZJAPARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Shkencor” në fushën e shkencave inxhinierike: inxhinieri ndërtimi; arkitekt/urbanist dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (*për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë*);
- b- Të kenë mbi 5 vjet përvojë pune në profesion;
- c- Të njohin dhe të përdorin programet kompjuterike (excel; autocad);
- d- Të zotërojnë një gjuhë të huaj.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit(ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendje gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dorëzimi i dokumentave për levizjen paralele duhet të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Tiranë/ Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk” Tiranë), brenda datës **16.12.2019.**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **17.12.2019** Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të lëvizjes paralele si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së lëvizjes paralele do të njoftohen individualisht nga Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin të Qarkut Tiranë, në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
- f- Ligji Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen

zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2

PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në “Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Këshillit të Qarkut Tiranë, duke filluar nga data 03.01.2020.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET EVEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” *(i ndryshuar)*.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” *(i ndryshuar)*.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme sivejton:

- a- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Shkencor” në fushën e shkencave inxhinierike: inxhinieri ndërtimi; arkitekt/urbanist dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë *(për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë)*;
- b- Të kenë mbi 5 vjet përvojë pune në profesion;
- c- Të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter (excel; autocad);

- d- Të zotërojnë një gjuhë të huaj.
- e- Të zotërojnë kualifikime dhe/ose certifikime profesionale.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si mëposhtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *(për diplomat të cilat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit);*
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën nëpunë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit(ID);
- d- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendje sgjyqësore;
- g- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimintuaj.

Dorëzimi i dokumentave për pranimin në shërbimin civil duhet të behet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore – Këshilli i Qarkut Tiranë/ Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk” Tiranë), brenda datës **21.12.2019.**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data **03.01.2020** Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimin në shërbimin civil, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimin në shërbimin civil do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore të Këshillit të Qarkut Tiranë, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- d- Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- e- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
- f- Ligji Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në **60 pikë**;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **25 pikë**;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **15 pikë**;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA EKOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Tiranë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria Juridike Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Tirane si dhe numër telefoni në 042225141 ose në adresën: Keshilli i Qarkut Tirane “Sheshi Mustafa Kemal Ataturk”, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimi në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi,

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Qarkut Tiranë duke filluar nga data 03.01.2020 si dhe numër telefoni në 042225141 ose në adresën: Keshilli i Qarkut Tirane “Sheshi Mustafa Kemal Ataturk”.